

# Gratë në tregun e punës

Përgatitur nga:  
**Instituti Riinvest**

**Dhjetor 2020**

---

*Ky punim është realizuar në kuadër të projektit "Dialog social për drejtësi shoqërore" që implementohet nga Demokraci për zhvillim, pjesë e Koalicionit për drejtësi sociale dhe të drejta socio-ekonomike, që financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe mbështetet nga Qeveria Suedeze. Përmbajtja e këtij punimi nuk reflekton doemos mendimet e Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qeverisë Suedeze.*

---



[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

---

SOCIAL  
DIALOGUE  
4 SOCIAL  
JUSTICE

---



## HYRJE

Ekonomia e Kosovës operon nën potencialin e saj zhvillimor për shkak të çështjeve të shumta, njëra prej të cilave është nën-përfaqësimi i grave në ekonomi. Përderisa gratë përfaqësojnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, roli i tyre në ekonomi dhe në shoqëri mbetet jo proporcional. Për të arritur potencialin e rritjes ekonomike, Kosova duhet të punojë drejt përfshirjes më të madhe të grave në ekonomi dhe të ofrojë mundësitë për fuqizimin ekonomik të tyre.

Në Kosovë gratë ballafaqohen me vështirësi të shumta në tregun e punës. Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vetëm dy në dhjetë gra janë aktive në tregun e punës, ndërsa pjesa tjetër është jashtë këtij tregu. Nga gratë që janë aktive në tregun e punës, shkalla e papunësisë është rreth 35%. Sipas Institutit Riinvest (2018) faktorët kryesorë që ndikojnë në jo-aktivitetin e grave në tregun e punës lidhen, mes tjerash, me: (i) kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve si dhe obligimet tjera në shtëpi që disproporcionalisht ngarkojnë gratë; (ii) pamundësia për të gjetur një vend pune të përshtatshëm; (iii) mungesa e aftësive e shkathtësive adekuate për një vend pune dhe mungesa e mekanizmave për të përafuar kërkesën dhe ofertën për punë- çështje kjo e cila nuk është trajtuar sa duhet.

Papunësia në Kosovë, përveç faktit se vjen nga pamundësia e ekonomisë që të krijoj vende të mjaftueshme pune, duket se ka edhe karakter strukturor.<sup>1</sup> Kjo veçanërisht rezulton të jetë problem domethënës për gratë.

Përballë këtij sfondi, Instituti Riinvest synon që të analizojë arsimimin e grave në ato profile të cilat kanë gjasa më të mëdha punësimi, mirëpo që nuk janë atraktive për gratë si dhe të trajtojë efikasitetin e mekanizmave që tentojnë të përafrojnë kërkesën dhe ofertën për punë, në mënyrë të veçantë agjencitë e punësimit të sektorit publik.

---

<sup>1</sup> Papunësia strukturore është lloj i papunësisë i cili vjen si pasojë e mospërputhjes në mes kërkesës dhe ofertës për shkathtësi të ndryshme në tregun e punës. Në këtë rast, në një ekonomi njëkohësisht ka vende të lira të punës dhe njerëz të papunë që do dëshironin t'i kishin këto vende pune, mirëpo punësimi nuk mund të realizohet për shkak se atyre u mungojnë shkathtësitë e kërkuara nga punëdhënësit

## DISKUTIM I GJETJEVE NGA TË DHËNAT DYTËSORE

Siç u evidentua, në Kosovë ka shpërputhje të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës krahasuar me burrat. Me vetëm 21%, Kosova përballet me një nga normat më të ulëta të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore, duke u radhitur kështu me pozitën më të ulët në raport me vendet e tjera të Ballkanit dhe ndër pozitat më të ulëta në nivel global (ASK, 2019). Për më tepër, situata e krijuar nga pandemia COVID-19 gjatë vitit 2020, ka rënduar edhe më tepër situatën e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Kur krahasojmë të dhënat e nxjerra nga anketa e fuqisë punëtore në Kosovë për tremujorin e tretë të vitit 2019 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, vërejmë se kemi rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore tek gratë me 0.7 pikë të përqindjes (nga 78.5% në 77.8%).

Sipas UNWOMEN (2020), në Kosovë, si pasojë e pandemisë, mbi dy të tretat e grave të punësuarra kanë përjetuar zvogëlim të orarit të punës ndërsa rreth 5% të tyre kanë humbur vendin e punës. Për shkak se një numër i konsiderueshëm i grave të punësuarra punon në sektorë që nuk mund të zhvillojnë lehtësisht aktivitetin e tyre nga distanca, të njëjtat, në masë të konsiderueshme janë detyruar që të marrin pushim pa pagesë për të ruajtur vendin e tyre të punës. Duke pasur parasysh se kopshtet, çerdhet dhe shkollat ishin të mbyllura për një kohë (që janë mbyllur kohë-pas-kohe edhe pas rihapjes), shumë gra janë detyruar që të zvogëlojnë numrin e orëve të punës në mënyrë që të akomodojnë kërkesat e fëmijëve të tyre.

Megjithatë, rrethanat e krijuara si pasojë e COVID-19 kanë rritur dukshëm edhe numrin e punëkërkuesve të regjistruar për herë të parë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK). Siç vërehet në tabelën 1, rritje e madhe e punëkërkuesve gra dhe burra është vërejtur gjatë muajve prill dhe maj, kryesisht si rezultat i mbështetjes sociale të ofruar nga qeveria si asistencë mujore në vlerë prej 130 euro, për qytetarët në kushte të rënda sociale, për qytetarët të cilët janë lajmëruar si të papunë në zyrat e punësimit, ose atyre që nuk kanë përfituar ndonjë të hyrë nga buxheti i Kosovës për muajt prill, maj, qershor të vitit 2020. Të dhënat e nxjerra nga APRK, tregojnë se nga data 1 mars deri me 31 tetor pranë zyrave të punësimit janë regjistruar 81,911 punëkërkues të rinj. Në mesin e të cilëve 38,343 (46.81%) janë gra, kurse 43,586 (53.21%) janë burra (D4D, 2020).

Tabela 1. Numri i punëkërkuesve të regjistruar për herë të parë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

	Burra	Gra	Totali
Mars	484	343	827
Prill	17,528	14,849	32377
Maj	18,239	16,845	35084
Qershor	1,932	1,539	3471
Korrik	1,204	927	2131
Gusht	1,844	1,403	3247
Shtator	1,246	1,264	2510
Tetor	1,091	1,173	2264
<b>Totali</b>	<b>43,568</b>	<b>38,343</b>	<b>81,911</b>

Burimi: D4D, 2020

Përderisa kjo rritje e numrit të punëkërkuesve është domethënëse, e njëjta nuk është refleksion real i ndryshimeve substanciale në tregun e punës. Në fakt, rritja e numrit të punëkërkuesve vjen kryesisht për faktin se në mënyrë që individët të kenë të drejtë në ndihmën e ofruar nga qeveria pas pandemisë, të njëjtit duhej të ishin të regjistruar në APRK. Sidoqoftë, kjo duhet të shfrytëzohet që të informoj më mirë politikat publike lidhur me dimensionet e problemit dhe të ndihmoj në dizajnimin sa më të mirë të këtyre politikave.

Të dhënat zyrtare sugjerojnë se në Kosovë, statistikat e punësimit ndryshojnë dukshëm për nga fushat e studimit. Përderisa, burrat në Kosovë kanë më shumë tendencë të zgjedhin fusha që lidhen me zanatin dhe tregtinë, gratë në anën tjetër zgjedhin fushat si shkencat sociale (Siddiqui et al., 2018). Sipas APRK-së, nga 70,790 individë sa janë regjistruar si të papunë në zyrat e punësimit në vitin 2019, vetëm 28.6% kanë deklaruar se kanë përfunduar shkollën e mesme profesionale; prej të cilëve pothuajse dy të tretat janë burra (Kalludra et al., 2019). Për më tepër, të dhënat vënë në pah se në mënyrë sistematike më shumë vende të punës krijohen dhe kërkojnë punëtorë me këtë nivel edukimi, ndërkaq në anën tjetër me rreth 12 pikë të përqindjes më pak gra të profilizuara me këtë nivel, regjistrohen si punëkërkuese.

Përkundër gjasave më të mëdha për punësim për punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme, këto pozita ende nuk konsiderohen si atraktive nga gratë. Për katërfish më pak gratë krahasuar me burrat kërkojnë punë në këto profile. Siç paraqitet në figurën 1, nga 10,354 individë sa ishin regjistruar gjithsej në këtë kategori si punëkërkues, vetëm 2,092 ishin gra (Kalludra et al., 2019). Si shpjegim, kjo kategori përfshin punonjësit e ndërtimit, punonjësit

me metal, makineri e profesione të tjera të ndërlidhura, punonjësit e artizanatit dhe printimit, punonjësit e profesionit elektrik, si dhe punonjësit në përpunimin e ushqimit, punimin e drurit, veshjeve dhe zejeve të tjera (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 2020).




Figura 1. Punëtorët e zejes dhe profesioneve të ngjashme  
Burimi: Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

Figura 2 paraqet profesionet më të kërkuara nga ana e punëdhënësve si dhe aplikimet për punësim në bazë të gjinisë për vitin 2019. Nga kjo, vërejmë se pikërisht profesionet që lidhen me punonjësit e zejes hyjnë në kategorinë e tri profesioneve më të kërkuara. Mirëpo, në anën tjetër, kur analizojmë strukturën gjinore të punëkërkuësve për këtë sektor, vërejmë se gratë janë ato që aplikojnë shumë më pak krahasuar me burrat. Kjo vjen kryesisht si rezultat i asaj se ka më pak gra të profilizuara me këtë nivel edukimi si dhe se këto profile konsiderohen më pak atraktive nga ato.




Figura 2. Vendet e lira të punës sipas profesionit për vitin 2019  
Burimi: Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

Të dhënat e APRK-së nuk janë të plotë pasi që sektori privat nuk e përdorë këtë institucion si kanal kryesor për rekrutimin e punëtorëve të rinj. Sipas Riinvest (2020), vetëm 14% e kompanive përdorin shërbimet e APRK-së për rekrutimin e punëtorëve të rinj. Në anën tjetër, mbi dy të tretat e kompanive punësojnë punëtorë të rinj nga pjesëtarët e familjes, përmes rekomandimeve nga miqtë, anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e biznesit. Në shifra një shifrore janë kompanitë që punësojnë përmes bashkëpunimit me shkolla apo agjenci të rekrutimit.

Megjithëkëtë, vërehet i njëjti trend edhe për kompanitë tjera për sa i përket pritjeve të tyre për vendet e punës që do të hapen. Sipas Riinvest (2020), pritjet për rritjen më të lartë të kërkesës për punëtorë raportohen për punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme, të shtyrë kryesisht nga ndërtuesit dhe profesionet e ngjashme të cilët janë një grup i madh dhe pritet të rriten me një normë më të lartë se mesatarja.<sup>2</sup>Rritja relative është gjithashtu më e lartë në grupet aktualisht të vogla të teknikëve dhe bashkëpunëtorëve profesional – shtyrë kryesisht nga bashkëpunëtorët profesional të shëndetit<sup>3</sup> – dhe punëtorët e zyrës dhe asistentët. Rritjet e pritshme të kërkesës për profesionistë, punonjës elementarë dhe menaxherë janë nën mesatare. Për profesionistët, ka dallime të theksuara brenda grupit, me rritje relativisht më të larta për profesionistët shëndetësorë (veçanërisht dentistët dhe farmacistët), profesionistët e TIK, inxhinierët dhe arkitektët e ndërtimtarisë dhe inxhinierët e telekomunikacionit, të ndjekur nga inxhinierët mekanikë dhe kimikë dhe profesionistët e biznesit e administrimit (kryesisht financat, shitjet, reklamat dhe marrëdhëniet me publikun) me rritje mbi mesataren e pritshme; dhe nga ana tjetër rritje modeste për profesionistët juridikë, socialë dhe kulturorë. Për profesionet elementare rritja përfshin të gjitha nën-grupet; këtu, një profesion i vogël që pritet të rritet veçanërisht shpejt është ai i asistentëve të përgatitjes së ushqimit, d.m.th. përgatitësve të ushqimit të shpejtë dhe ndihmësve të kuzhinës.

Thënë në tërësi, profesionet ku pritet për rritje të kërkesës për punëtorë të rinj është më e lartë, nga ana e ofertës, shumica e tyre dominohen nga burrat. Kjo pasqyron më së miri këtë hendek

---

<sup>2</sup> Disa profesione aktualisht më të vogla me rritje të konsiderueshme në terma relativë përfshijnë mekanikë dhe riparues të makinerive bujqësore dhe industriale, mekanikë dhe riparues të automjeteve motorike, punëtorë dhe montues të makinerive metal punuese dhe punëtorë dhe montues të makinerive dru punuese, si dhe rrobaqepës dhe rrobaqepës fustanesh. Nga ana tjetër, rritja relative e pritjes së asistentëve është relativisht e vogël.

<sup>3</sup> Përkundrazi, rritja e pritjes në biznes dhe administrim është relativisht e vogël.

strukturor sa i përket orientimit të grave në ato profesione që kanë gjasa më të mëdha punësimi.

Dy problem kryesore evidentohet në këtë kuadër. Së pari, në Kosovë shumë pak të rinj marrin këshilla lidhur me orientimin në karrierë. Sipas Riinvest (2020), mbi 75% e të rinjve zgjedhin karrierën e tyre në bazë të konsultimeve me familje dhe në bazë të interesit të tyre personal. Vetëm rreth 25 përqind e të rinjve janë konsultuar me ndonjë mësimdhënës apo, në raste shumë më të rralla, me këshilltar karriere. Në mungesë të një këshillimi më adekuat e profesional, të rinjtë nuk bëjnë zgjedhje të informuar kur përzgjedhin karrierën e tyre. Kjo pastaj thekson edhe më tej stereotipet gjinore lidhur me profesionet, gjë që thëllon edhe më shumë diferencat ndërmjet grave e burrave.

Së dyti, masat aktive të tregut të punës nuk rezultojnë të jenë shumë efikase. Sipas një vlerësimi të bërë nga GIZ (2019) cituar nga Riinvest (2020), vlerësohet se efektiviteti i masave më të rëndësishme aktive të lidhura me tregun e punës është disi i diskutueshëm. Përqendrimi rajonal i vendosjes së punëtorëve, niveli i ulët i ndërgjegjësimit për skemat në disa rajone, mungesa e konsistencës në aspektin e cilësisë dhe ofrimit të shërbimeve të këshillimit të punësimit, pajtueshmëria e dobët nga zyrtarët e zyrës së punësimit në lidhje me monitorimin e vizitave gjatë vendosjes së punëtorëve, janë disa nga dobësitë kryesore që dëmtojnë efektivitetin e masave që lidhen me politikat aktive të tregut të punës në Kosovë. Për më tepër, këto masa nuk përdorin një thjerrëz të aspektit gjinor gjatë dizajnit dhe/apo zbatimit.



## PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Është evidente se gratë në tregun e punës në Kosovë janë të nën-përfaqësuar. Gjithashtu, në mënyrë sistematike mungojnë politikat publike që do duhej të kishin për qëllim ngushtimin e këtij hendeku. Përtej problemeve që lidhen me barrën e pabarabartë të grave në kryerjen e punëve të shtëpisë (përfshirë kujdesin për fëmijë dhe të rritur), vërehet se gratë sistematikisht orientohen në ato profesione që kanë gjasa më të vogla punësimi. Rezultatet sugjerojnë se si punëkërkuese gratë gravitojnë në ato profesione për të cilat ka kërkesa më të vogla nga sektori privat tek APRK-ja. E njëjta konfirmohet kur analizohen të dhënat e një mostre përfaqësuese të bizneseve nga sektori privat.

E gjithë kjo ndodhë në kushtet kur ka mungesë të ndjeshme të shërbimeve të udhëzimit në karrierë dhe mungesë e masave efikase aktive të tregut të punës që kanë për objektive specifike avancimin e pozitës së grave në këtë kontekst. Karakteri strukturor i papunësisë në Kosovë, i cili duket se prekë gratë në mënyrë disproporcionale, kërkon përgjigje më adekuate nga politikat publike.

Rrjedhimisht, rekomandohet që qasja në shërbimet e udhëzimit në karrierë duhet të rritet në shkolla dhe zyra punësimi të cilat mund të ofrojnë informacione dhe udhëzime të nevojshëm për të rinjtë që të bëjnë zgjedhje të informuara në lidhje me karrierën e tyre. Gjithashtu, masat aktive të tregut të punës duhet të rriten dhe të kenë shtrirje më të madhe. Çdo skemë duhet të ketë qëllime të qarta dhe mbikëqyrje të duhur në kompani si dhe vëmendje të veçantë gjatë vendosjes në këto vende të praktikës punëtorët e rinj. Në këtë kuadër, duke parë përmasat e problemit, mund të caktohen objektiva të qarta që për synim kanë avancimin e pozitës së gruas në tregun e punës. Sigurisht se krahas këtyre masave, duhet punuar paralelisht edhe në uljen e faktorëve tjerë që pengojnë përfshirjen e grave në tregun e punës, që u cituan në hyrje të këtij punimi por që nuk ishin objekt i trajtimit nga ky punim.

## REFERENCAT

- Democracy for Development (D4D), 2020. Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës, Prishtinë, Republika e Kosovës.
- Dobranja, D., Mehmeti, I., Beqiri, G., Mati, V., Hashani, A., 2018. Drejt Fuqizimit- Faktorët që ndikojnë në vendimet ekonomike të grave në Kosovë, Prishtinë: Instituti Riinvest.
- Hajrizi, B., Demaj, B., Rama, R. & Thaçi, B., 2019 . Anketa për Fuqinë Punëtore në Kosovë, Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Hajrizi, B., Demaj, B., Rama, R. & Thaçi, B., 2020. Anketa e Fuqisë Punëtore, Prishtinë, Kosovë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.
- Kalludra, S., Klinaku, M. & Rexha, J., 2019. Punësimi dhe Aftësimi Profesional, Prishtinë, Kosovë: Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.
- Kampelmann, S., & Rycx, F. (2012). The impact of educational mismatch on firm productivity: Evidence from linked panel data. *Economics of Education Review* , 31(6): 918-931
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. (2020). *Klasifikimi i profesioneve në Kosovë*. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Riinvest, 2020. Punësimi dhe analiza e tregut të punës në Kosovë, Instituti Riinvest, Prishtinë, Republika e Kosovës.
- Siddiqui, H., Gashi, A., Higgins, J., Dasgupta, B., Puciloëski, M., 2018. Kosovo Labor Force and Time Use Study, Prishtinë: MCC KOSOVO.
- UN Women. (2020). Ndikimi i COVID-19 në jetën dhe jetesën e Grave dhe Burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore: Rezultatet Preliminare nga Vlerësimi i Shpejtë Ginor.